



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-15505

Me date: 06.03.2023

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 13, nenit 58, paragrafi 1, pika (f) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), neni 2, nenit 4, pika 1 dhe pika 2.1, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2018 për Caktimin e stafit mbështetës në Komuna, nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr.-8336, të datës 04.11.2008 Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Shefit të Kabinetit të Kryetarit

1. **Z. Brahim THAQI**, nga fshati Sallagrazhdë, Komuna e Suharekës, i lindur me datë 03.01.1986, me numër personal 1500607382, me përgaditje profesionale gazetar, **Emërohet:**

1.1 Shef i Kabinetit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Suharekës.

2. Të drejtat, detyrat, përgjegjësit dhe orari i punës të shefit të kabinetit përcaktohen nga Kryetari i Komunës, duke u bazuar në legjislacionin përkatës të punës të aplikushëm në Republikën e Kosovës.
3. Marrëdhënia e punës e Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Komunës fillon nga data 06.03.2023 dhe pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyra e Personelit dhe Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa e Komunës së Suharekës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës së Suharekës dhe shfuqizon **Vendimin 01-Nr.-016-41946 të datës 28.06.2019.**

Dërgohet:

I Emëruari,

DEBF-së

Zyra e Personelit dhe

Arkivit





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-17840

Me datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit, Nr.-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të republikës së Kosovës, nr. 25/2008", e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr. 05/ L-031, për procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , Nr. 20/ 2016", Kryetari i Komunës së Suharekës, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet stafi i kompanisë **RA-TA SH.P.K.** me numër unik identifikues 810087917, përkatësisht Z. Faton Çitaku (1174906943), që të na përfaqësojë tek institucionet përkatëse KEDS dhe ZRRE (Zyra e Rregullatorit të Energjisë) për kompletimin e dokumentacionit dhe aplikimin në ZRRE për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsumim.


15.03.2023

Kryetari i Komunës



Bali MUHARREMAJ



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-12097

Me datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/ L-031, nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës merr këtë:

A K T V E N D I M

1. **Visar Kuqi**, CAKTOHET Menaxher në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Suharekës dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Suharekës.
2. Organi mbikëqyrës ka për detyrë t'i kryej punët, të informon dhe të përpilon raport me shkrim për punët e kryera sipas Marrëveshjes konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe akteve tjera nënligjore.

Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës



Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

- Mbikëqyrësi

-Arkiva



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 410-17839

Me datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13, 18 dhe nenit 58 Ligjit 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008, nenit 44, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative <Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016, nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-153, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës Kryetari i Komunës në Suharekë, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Formohet komisioni me qëllim të verifikimit të pronave të uzurpuara:

1.1 Ardian Kotorri.....Kyesues
1.2 Kadri Sopaj.....Anëtar
1.3 Artan Bytyqi.....Anëtar

II. Me qëllim të mbrojtjes së pyjeve në Komunën e Suharekës detyrat e këtij janë që ta bëjë verifikimin e pronave të uzurpuara dhe pas konstatimit të uzurpimeve të ndërmmarrin masa ligjore dhe të fillohet procedura ndaj uzurpuesve.

III. Pas konstatimit të uzurpimeve të njoftohet Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Koordinues Rajonal me seli në Prizren.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

-Anëtarët e komisionit

- Arkiva

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-18363

Me date: 16.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit, Nr.-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të republikës së Kosovës, nr. 25/2008, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr. 05/ L-031, për procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , Nr. 20/ 2016" dhe kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenje Sociale, me nr. të protokollit 01-Nr.104-3321 të datës 15.01.2021, Kryetari i Komunës së Suharekës, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet z. Labinot Halitjaha – Drejtor në Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, që të ndërmerret të gjitha veprimet administrative lidhur me detyrat e ZKF si nënshkrimin e deklaratave për disponueshmërinë e mjeteve për projektet kapitale, mallra dhe shërbime, komunalit etj. Poashtu i njejti duhet të kryej të gjitha detyrat mbi alokimin e mjeteve, zotimin e tyre si dhe çdo punë tjetër e cila lind nga kjo detyrë.

Autorizimi vlen për kohë të pacaktuar.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

-I autorizuari

-Arkiva





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-19063

Me date: 20.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të dates 04.11.2008, neni 44 të LPPA-së Nr-05/L-031, Kryetari i Komunës merr këtë:

AKTVENDIM

- I. Të shpallet tenderi për “Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit - ritender”.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset zyra e prokurimit.
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Duke e parë të arsyeshme dhe të nevojshëm transportimin e xënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit, u vendos që të shpallet tenderi për “Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit”, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Të njoftohen:
Zyra e Prokurimit;
Evidenca.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-19378

Me datë: 21.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.-03/L-040, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/ L-031, nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës merr këtë:

A K T V E N D I M

1. **Albulena Kokollari**, caktohet Koordinatorë në Marrëveshjen e Bashkëpunimit në mes të Komunës së Suharekës dhe Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus në Kosovë dhe WEnerpreneur.
2. Koordinatorja ka për detyrë t'i kryej punët, të informon dhe të përpilon raport me shkrim konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe akteve tjera nënligjore.

Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

- Koordinator/i/ja;
- Arkiva.





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-19083

Datë 21.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), nenin 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008 dhe dispozitave të nenit 53, lidhur me nenin 66, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e aneks kontratës

1. **Shfuqizohet-** Aneks kontrata me numër të protokollit, 01-Nr-016-20420, e datës 04.06.2020, e lidhur në mes Komunës së Suharekës dhe firmës "Mendi E&J SH.P.K", me seli në Shirokë Rr. "Ukë Bytyçi", të cilën e përfaqëson Armend Kuçi, nga Suhareka dhe gjendja kthehet sipas kontratës bazë me numër të protokollit 01-Nr-16-3170 të datës 20.02.2015 e lidhur në mes Komunës së Suharekës dhe firmës "Triolspan" Sh.P.K, me seli në Shirokë, Komuna e Suharekës, të cilën e përfaqëson Armend Kuçi nga Suhareka.
2. **OBLIGOHET-** Drejtoria për shërbime pronëso-ro-juridike dhe kadastër që në librat kadastrave firmën e lartcekur ta kthej gjendjen e mëparshme juridike, sipas kontratës bazë 01-Nr-16-3170 të datës 20.02.2015.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës në Suharekë.

Të njoftohen;
DEFB-ja
DSHPJK-ja
Pala
Evidenca


Kryetari i Komunës
Bali MUHARREMAJ



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 0/6 - 19260

Me datë: 21.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet Afrim Bytyqi, Përfaqësues Ligjor i Komunës që sipas Legjislacionit në fuqi dhe përkrahimit të detyrave të punës, të jep vlerësime Juridike lidhur me kontratat për dhënie në shfrytëzim që në emër të Komunës i nënshkruan Kryetari i Komunës. Ky vlerësim duhet të ipet para nënshkrimit të kontratës.

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:
-Të autorizuarit
-Arkiva



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-20255

Me datë: 27.03.2023

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit, Nr.-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të republikës së Kosovës, nr. 25/2008”, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit Nr. 05/ L-031, për procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës , Nr. 20/ 2016”, Kryetari i Komunës së Suharekës, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet **Driton MALIQAJ** zv. Drejtor në QKMF në Suharekë, që të menaxhoj me buxhetin e QKMF – “Rexhep Kuçi”, Komuna e Suharekës, poashtu i njejtë është përgjegjës për shpenzimin e buxhetit konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Ky Autorizim vlenë për vitin fiskal 2023, dhe nuk mund të shërbej për qëllime tjera.

Kryetari i Komunës



Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

- I autorizuari
- Arkiva



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 410-20614

Me datë: 28.03.2023

Duke u bazuar në nenin 74, paragrafi 3, pika 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publik « Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 08/2019 » e në mbështetje të nenit 18, të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për disiplinën e zyrtarëve publikë, Kryetari i Komunës, nenit 44, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016, Kryetari i Komunës në Suharekë, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave, që parashtrohen nga nëpunësit të shërbimit publik që janë të punësuar në institucionet publike e që janë nën menaxhimin e Komunës së Suharekës, kundër vendimeve të komisionit disiplinor, kur pretendojnë se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës, të drejtat në procedurën e konkurrimit të hapur dhe ankesat tjera në këtë përbërje:
 - 1.1 Shkëlqim Salihu.....Kryesues
 - 1.2 Ardita KolgeciAnëtare
 - 1.3 Shqipron GallopeniAnëtar
- II. Detyrë e këtij komisioni është që të vendos lidhur me ankesat, që parashtrohen nga nëpunësit të shërbimit publik që janë të punësuar në institucionet publike e që janë nën menaxhimin e Komunës së Suharekës, kundër vendimeve të komisionit disiplinor, kur pretendojnë që i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës, të drejtat në procedurën e konkurrimit të hapur dhe ankesat tjera me punësimin, rekrutimin, selektimin, gradimin, degradimin e rasteve tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe nën ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
Ardita Kolgeci
- III. Mandati i anëtarëve të komisionit është 3 vjeçar.
- IV. Anëtarët e komisionit për punën që do ta kryejnë do të kompenzohen sipas legjislacionit në fuqi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfuqizon vendimin me numër 01-Nr. 410-1946 të datës 11.01.2022.

Të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Arkiv





ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 06-19630

Me date: **22.03.2023**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Qllirim Gegaj , Zyrtar në Drejtorinë e Administratës- Suharekë caktohet Menaxher i Kontratës: "Shfrytëzim i fotokopjeve dhe printerave me qira " Me nr.të prokurimit AQP18-009-2-2-1/UA /2016 18-6489-211-5

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfuqizon vendimin 01-016-17054 te dates 21.03.2023.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:

-Menaxherit të projektit,

- Arkivi



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-19629

Me date: **22.03.2023**

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Halim Kuqi-Mirëmbajtes-Përgjegjës në Komunën e Suharekës caktohet Menaxher i Kontratës: “ Furnizimi me material hidrosanitari –ndriqim elektrik etj për Administratë , QKMF dhe shkolla. Me nr.të prokurimit 624-22-3122-1-1-1/624-022-05-111 .

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfuqizon vendimin 01-016-14296 te dates 28.02.2023.

Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës

Dergohet:

-Menaxherit të projektit,

- Arkivi